



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:279065  
Datë: 25.06.2024  
Numri i dokumentit: 05855403  
C.nr.1823/2021

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunëtoreshen profesionale Shkurte Kadriu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.G nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Blerina Dërmaku avokate nga Gjilani, kundër të paditurës Kompania e Sigurime "...", me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor e publik, më datë 10.06.2024, mori dhe përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.G nga Gjilani, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, dhe

**I.**Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, që t'ia paguajë paditësit shumën prej 4,830.00 euro, në emër të dëmit material të shkaktuar nga vetaksidenti i datës 21.02.2021, si dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 913.08 euro, e në shumë të përgjithshme prej 5,740.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke llogaritur nga data 10.12.2021, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditë, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

**II.** Detyrohet e paditura, që në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia paguajë paditësit shumën prej 1,222.40 euro, në afat prej 15 ditë, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

**A r s y e t i m**

Paditësi S.G nga Gjilani, më datë 10.12.2021, në këtë gjykatë ka paraqitur padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit. Paditësi, në padi, precizim të padisë, gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si dhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se më datë 21.02.2021, rreth orës 22:20, në rrugën Qarkore në Gjilani, ka ardhur deri tek vetaksidenti i komunikacionit rrugor dhe deri te aksidenti ka ardhur atëherë kur njësia "A", e cila ishte duke vozitur në rrugën.qarkore nga drejtimi i rrugës magjistrale Kamenicë - Prishtinë, me të arritur afër pikës së derivateve "Euro Miti" në Gjilani, nga mos eksperiencia në drejtimin e automjeteve (pa patent shofer), fillon të bëjë tejkalim të pa sigurt, ku në këtë rast e humb kontrollin mbi drejtimin e automjetit, del jashtë rrugës në anën e

majtë dhe hyn në hapësirën e pompës së karburanteve “Euro Miti”, ku fillimisht e godet një shtyllë elektrike, pastaj përplasat në mbrojtëset e pompës, në raftet e vajrave, shtyllën e objektit dhe në fund përfundon në shtyllën e dytë elektrike, ku si pasojë e kësaj shkaktohet vetaksident me dëme materiale në automjet si dhe dëme të konsiderueshme materiale i shkaktohen pikës së derivateve “Euro Miti” në Gjilan. Tutje ka theksuar që në rastin e shkakimit të aksidentit, shkakuesi i dëmit ishte i siguarar te e paditura me nr. të policës 0007608018, me afat të skadimit deri më 08.10.2021. E paditura Kompania e Sigurime “...”, paditësit i’a ka ofruar shumën për dëmshpërblim në vlerë prej 2,644.60 euro, mirëpo pasi që e paditura nuk ka shprehur vullnetin të kompensojë dëmin në vlerë reale, paditësi është detyruar që t’i drejtohet gjykatës, dhe nga gjykata të kërkoj që ta aprovojë të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “...”, që t’ia paguaj paditësit, në emër të kompensimit të dëmit material shumën prej 4,830.00 euro, të shkakuar nga aksidenti i datës 21.02.2021, si dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 913.08 euro, e në shumë të përgjithshme prej 5,740.00 euro, me kamatë ligjore prej 12%, duke llogaritur nga data 10.12.2021, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 156.00 euro, për parashtresën e datës 23.03.2022 shumën prej 156.00 euro, për seancën e datës 05.03.2024 shumën prej 135.20 euro, për seancën e datës 17.04.2024 shumën prej 67.60 euro, për seancën e datës 13.05.2024 shumën prej 67.60 euro, për parashtresën e datës 15.05.2024 shumën prej 156.00 euro, për seancën e datës 10.06.2024 shumën prej 135.20 euro, për parashtresën e datës 10.06.2024 shumën prej 156.00 euro, për ekspertizën financiare të datës 15.04.2024 shumën prej 250.00 euro, për ekspertizën e ndërtimtarisë shumën prej 350.00 euro, për taksë gjyqësore në shumë prej 61.00 euro, e në shumë të përgjithshme prej 1,690.60 euro.

E paditura në përgjigjen në padi, nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, mirëpo ka kontestuar vetëm lartësinë e saj, pasi që shuma e kërkuar nga paditësi bie ndesh me vëllimin e dëmit të shkakuar dhe se vlerësimi i dëmit nga e paditura në shumë prej 2,644.60 euro është real, konform praktikave të kompensimit të dëmit material në procedurë jashtëgjyqësore, andaj, edhe ka deklaruar që janë të gatshëm që palën e dëmtuar ta kompensojnë me këtë shumë.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Procesverbali nga raporti i aksidentit me nr.2021-CR-115 i datës 21.02.2021; Kërkesa për kompensimin e dëmit, e dt. 02.03.2021; Njoftimi dhe oferta e të paditurës, e dt. 16.04.2021; Ankesa drejtuar komisionit të shkallës së dytë të kompanisë së sigurimeve “...”; Njoftimi përmes e-mailit, i dt. 20.08.2021, lidhur me refuzimin e ankesës; Procesverbali i ofruar nga “Euro Miti” SHPK, me nr. 810652554, i vulosur nga ana e “Euro Miti” SHPK, me seli në Ferizaj; 1 CD e incizimit nga vendi i ngjarjes në ditën e aksidentit; 8 foto shitesë nga vendi i ngjarjes; Fatura tatimore, nr. 137, e dt. 05.11.2020; Fatura tatimore, nr. 157, e dt. 28.11.2020; Fatura tatimore, nr. 134, e dt. 01.11.2020; Fatura tatimore, nr. 136, e dt. 01.11.2020; Fatura tatimore, nr. 135, e dt. 01.11.2020; Fatura tatimore e dt. 22.02.2021; Fatura nr. 21/1639, e dt. 23.02.2021; Fatura nr. 032606, e dt. 26.03.2021; Fatura nr. 005/2021, e dt. 22.06.2021; Ekspertiza financiare e ekspertit financiar F.Q, e pranuar në këtë gjykatë më dt. 15.04.2024; Ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë Agan Ramadani, e pranuar në këtë gjykatë më dt. 13.05.2024.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka gjetur se, kërkesëpadia e paditësit është e bazuar me ligj..

Gjykata, fillimisht konstaton se e paditura është ftuar në mënyrë të rregullt për seancat gjyqësore, por që përfaqësuesja e saj Kompania e Avoketëve „ Arbreshë” me seli në Hajvali, nuk ka marrur pjesë në seancat gjyqësore, me arsyetimin se janë të zënë me çështje të tjera në gjykatat e Kosovës, mirëpo që parashtrësës nuk i kanë bashkangjitur asnjë provë materiale me të cilën do të konfirmoheshin faktet e paraqitura si në parashtrësë. Andaj gjykata me propozimin e përfaqësuesit të paditësit ka vendosur që seancat të mbahen pa prezencën e përfaqësueses së të paditurës.

Gjykata, konstaton se në mes palëve ndërgjyqëse nuk janë kontestuese faktet sa i përket bazës juridike të kërkespadiës si dhe faktet se me datën 21.02.2021, në rrugën qarkore në Gjilan ka ardhur deri tek vetaksidenti, kur ngasësi i njësisë „A” Y.Bnga Gjilani, i siguruar tek e paditura në bazë të policës së sigurimit nr.0007608018, ka shkakuar vetaksident duke vozitur automjetin e tij në rrugën qarkore të Gjilanit në drejtim të Rrugës së Prishtinës, ku me të arritur afër pikës së derivateve “Euro Miti” në Gjilan, nga moseksperienca në drejtimin e automjeteve (pa patent shofer), fillon të bëj tejkalim të pa sigurt, ku në këtë rast e humb kontrollin mbi drejtimin e automjetit, del jashtë rrugës në anën e majtë hynë në hapësirën e pompës “Euro Miti” në Gjilan, ku fillimisht e godet një shtyllë elektrike, pastaj përplasat në mbrojtëset e pompës, në raftet e vajrave, shtyllën e objektit dhe në fund përfundon në shtyllën e dytë elektrike, e si pasojë e kësaj shkaktohet vetaksident me dëme materiale në automjet si dhe dëme të konsiderueshme materiale i shkaktohen pikës së derivateve “Euro Miti” në Gjilan, ngase këtë fakt e dëshmon vet Raporti i aksidentit me nr.2021-CR-115 i datës 21.02.2021. Po ashtu, nuk është kontestues as fakti tjetër se paditësi ju kishte drejtuar të paditurës me kërkesë për kompenzimin e dëmit, ashtu që e paditura ka shqyrtuar kërkesën e paditësit për kompensimin e dëmit material dhe ka konstatuar që kërkesa e paditësit ka bazë për kompensim dhe paditësit i ka ofruar ofertë për kompenzim në shumë prej 2,644.60 euro, fakte këto që konfirmohen nga njoftimi dhe oferta e dt. 16.04.2021, por që paditësi nuk e kishte pranuar një ofertë të tillë, ashtu që me ankesë ju kishte drejtuar komisionit të shkallës së dytë të Kompanisë së Sigurimeve “...” me kërkesë për kompenzim dëmi në lartësi prej prej 7,848.10 euro, duke i’ bashkangjitur kërkesës procesverbalin me nr. 810652554, i vulosur nga ana e “Euro Miti” SHPK, me seli në Ferizaj e datës 09.03.2021, por që e paditura një kërkesë të tillë nuk e kishte pranuar.

Gjykata, në këtë çështje kontestimore sa i përket bazës juridike të padisë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që në nenin 136, paragrafi 1 dhe 2 përcakton se “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.* Kurse në nenin 137 të LMD-së janë përcaktuar dhe sqaruar edhe format e dëmit, se “*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur).*”

Gjykata, konstaton se në mes palëve është kontestuese lartësia e kompenzimit të dëmit material qoftë të atij real, ashtu edhe fitimi i humbur, andaj, me qëllim të përcaktimit të lartësisë së dëmit, janë caktuar ekspertë të lëmive përkatëse të financave për të llogaritur fitimin e humbur dhe ekspert i ndërtimtarisë me qëllim të vlerësimit të dëmit real.

Nga ekspertiza financiare e ekspertit financiar F.Q, e pranuar në këtë gjykatë më datë 15.04.2024, dhe nga dëgjimi i tij në seancën e datës 10.06.2024, gjykata vërtetoi faktin se për shkak të ndërprejes së aktivitetit punues të paditëses si pasojë e aksidentit, fitimi i humbur për 3 ditë është në lartësi prej 913.08 euro edhe ate fitimi i humbur nga ndërpreja e aktivitetit të

pikës së karburanteve, shuma prej 613.08 euro (përkatësisht 3 ditë x 204.36euro), shuma prej 375 euro (përkatësisht 3 ditë x 125 euro), nga nga moshshitja e deriveteve të naftës, dhe nga mosfunktionimi i restaurantit shuma prej 150.00 euro (përkatësisht 3 ditë x 50 euro), që gjithsej rezulton 913.08€.

Faktin se pika e karburanteve „Euro Miti” në Gjilan, në përbërje të saj ka edhe market dhe restaurant,ku për tre ditë nuk ka funksionuar, gjykata e ka vërtetuar me daljen e saj në vendin e ngjarjes. Andaj, këto fakte i ka pasur parasysh eksperti financiar me rastin e përpilimit të ekspertizës financiare, sa i përket fitimit të humbur për tre ditë pas rastit të ndodhur e deri në sanimin e pikës së karburanteve.

Kurse eksperti i ndërtimtarisë Agan Ramadani, në ekspertizën e tij të pranuar në këtë gjykatë më dt. 13.05.2024, si dhe nga dëgjimi i tij në seancën e datës 10.06.2024, ka konstatuar se vlera e përgjithshme e dëmit material-real të shkaktuar nga vetaksidenti i komunikacionit i datës 21.02.2021 në pajisjet përcjellëse të pikës së karburanteve „Euro Miti” Sh.P.K është në shumë prej 4,830.00 euro, për shkak të dëmtimit të shtyllave të ndriqimit, dëmtimit të pllakave të keramikës, dëmtimi i fasadës së dëmtuar tek shtylla e ndriqimit, dëmtimi i aparatit të fikjes së zjarrit, dëmtimi i gurëve skajor, dëmtimi i mbrojtësve të profileve metalike dhe dëmtimi i pompës furnizuese, të cilat eksperti i ka paraqitur edhe në foto për secilën veq e veq dhe se eksperti vlerësimin e dëmit e ka bërë në bazë të gjendjes paraprake të pikës së karburanteve „euro Miti” SH.P.k në Gjilan, duke shfrytëzuar inqizimin në CD ku shihen rasti i ndodhur dhe dëmtimet në këtë pikë të shitjes, kurse për bazë ka marr qmimet momentale të ndërtimit në tregun tonë duke dhënë përmasat dhe përlllogarinë për secilin pozicion veq e veq dhe ka ardhur në përfundim se dëmi material real është 4,830.00€

Me rastin e vendosjes meritorë të qështjes gjykata i’ a ka shprehur besimin e plotë konstatimeve nga ekspertiza e ekspertit financiar, lidhur me fitimin e humbur dhe ekspertit të ndërtimtarisë Agan Ramadani, ngase ekspertizat janë objektive dhe të drejta dhe ekspertët konstatimet e tyre i kanë bazuar edhe në përputhje të provave materiale që kanë pasur si dhe eksperti deri tek një përfundim i tillë ka ardhura duke marrur për bazë edhe faturat tatimore, nr. 137, e datës 05.11.2020, në vlerë prej 40.00 euro, fatura tatimore, nr. 157, e dt. 28.11.2020, fatura tatimore, nr. 157, në vlerë prej 384.00 euro,fatura tatimore, nr. 134, e dt. 01.11.2020, fatura nr. 134, në vlerë prej 849.30 euro, fatura tatimore, nr. 136, e dt. 01.11.2020, fatura tatimore, nr. 134, në vlerë prej 580.80 euro, fatura tatimore, nr. 135, e dt. 01.11.2020, fatura tatimore, nr. 135, në vlerë prej 396.40 euro, fatura tatimore e dt. 22.02.2021, në vlerë prej 350.00 euro, fatura nr. 21/1639, e dt. 23.02.2021, në vlerë prej 350.00 euro,fatura nr. 032606, e dt. 26.03.2021, fatura tatimore, nr. 032606, në vlerë prej 491.00 euro, fatura nr. 005/2021, e dt. 22.06.2021, fatura tatimore, nr. 005/2021, në vlerë prej 5,000.00 euro, e të cilat fatura në përmbajtje të tyre kanë për objekt blerjen e mallrave të dëmtuara nga vetaksidenti e të cilat ekspertëve i kanë shërbyer për të dhënë konstatimet e tyre në ekspertiza.

Me rastin e vendosjes meritorë të qështjes, lidhur me kërkesën e paditësit për lartësinë e fitimit të humbur, gjykata ka marrur për bazë vetëm pjesën e ekspertizës financiare të ekspertit financiar F.Q, ku eksperti ka konstatuar fitimin e humbur për tre ditë të ndërprejes së aktivitetit të biznesit të paditësit, por jo edhe pjesën tjetër të konstatimit të dëmit material në pajisjet e pikës së karburantit dhe mallrat e dëmtuara, pasi që ato kërkesa janë në kompetencë dhe autorizim për vlerësim profesional për t’u përlllogaritur vetëm nga eksperti i ndërtimtarisë, meqë natyra e sendeve dhe pajisjeve të dëmtuara, i përkasin vlerësimin të ekspertit të fushës së ndërtimtarisë.

Andaj, në një gjendje të tillë faktike të vërtetuar e konform nenit 169, paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së ku është përcaktuar se *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të*

japë shpërblimin në të holla” gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke detyruar të paditurën që paditësit t’ia kompenzojë këtë dy forma të dëmit material.

Për kamatën, Gjkata ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, e që është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. 265/2020, të datës 02.12.2020, ku në këtë dispozitë ligjore është përcaktuar se „Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë. Andaj, pretendimi i paditësit për kamatën në lartësi prej 12%, është i pabazuar, ngase e paditura e ka trajtuar kërkesën për dëmshpërplim, por që nuk kanë arritur ta konkretizojnë dhe të arrijnë një marrveshje jashtgjyqësore.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedure dhe kërkesën e specifikuar për shpenzime, dhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 156.00 euro, për seancën e datës 05.03.2024 shumë prej 135.20 euro, për seancën e datës 17.04.2024 shumë prej 67.60 euro, për seancën e datës 13.05.2024 shumë prej 67.60 euro, për seancën e datës 10.06.2024 shumë prej 135.20 euro, për ekspertizën financiare të datës 15.04.2024 shumë prej 250.00 euro, për ekspertizën e ndërtimtarisë shumë prej 350.00 euro, për taksë gjyqësore në shumë prej 61.00 euro, e në shumë të përgjithshme prej 1, 222.40 euro. Gjkata, nuk ia ka njohur paditësit kërkesat lidhur me shpenzimet e procedurës edhe atë për tre parashtresa nga 156.00€, ngase sipas TOAK, parashtresat me të cilat rregullohen dhe plotësohen kërkesat nuk hyjnë për pagesë, meqë ato kanë mundur të bëhen edhe në seancat gjyqësore në mënyrë të drejtpërdrejt.

Nga të cekurat më lartë, bazuar në nenin 143, parag.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2021:279065, 10.06.2024**

**Gjyqtari,**  
**Berat Spahiu**

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.